



DORACAK PËR LIGJIN PËR SHËNDETIN DHE SIGURINË NË PUNË

Projekt i:

Organizatës Ndërkombëtare të Punës

Agjencisë Austriake për Zhvillim

Realizues:

Konfederata e Punëdhënësve

Organizata e Punëdhënësve

Mbështetje profesionale:

Shoqata Maqedonase për Mbrojtje Gjatë Punës

Prof. Dr. Elisaveta Jasna Stikova

Tirazhi: 150

Shkup, Dhjetor 2009

Përmbajtja

- 1. Hyrje**
- 2. Objektivi kryesor i Manualit për Ligjin për siguri dhe shëndet gjatë punës**
- 3. Baza ligjore**
- 4. Detyrimet e punëdhënësve**
- 5. Detyrimet e personit profesionist**
- 6. Detyrime të tjera të punëdhënësit**
- 7. Detyrimi i punëdhënësit për ta informuar Inspektoratin e Punës**
- 8. Analiza e vendit të punës, mjedisit dhe mjeteve të punës**
- 9. Evidenca e punëdhënësit**
- 10. Të drejtat dhe detyrimet e të punësuarve**
- 11. Autorizimet e Inspektoratit të Punës**
- 12. Gjoba**
- 13. Aktet nënligjore nga Ligji për siguri dhe shëndet gjatë punës**
- 14. Informata**

1. Hyrje

Siguria dhe shëndeti në punë është fushë multidisiplinore - strukturë e teknikës, fizikës, medicinës, organizimit, kimisë etj. Mbrojtja gjatë punës, përkatësisht siguria dhe shëndeti gjatë punës si përmbledhje e masave, normave dhe standardeve të përcaktuara për krijimin e kushteve të sigurta për punë, është kategori kushtetuese.

Siguria dhe shëndeti gjatë punës sipas legjislacionit tonë është konceptuar si pjesë përbërëse e organizimit të punës dhe procesit të punës dhe mbi këtë bazë sigurohet çdo punëtor dhe çdo punë e dobishme, pa marrë parasysh llojin dhe kompleksitetin e punës, gjë që është në përputhje me parimin kushtetues lidhur me të drejtën e çdo punëtori për mbrojtje gjatë punës.

E drejta për shëndet dhe e drejta për siguri në punë janë të drejta universale të njeriut dhe të punës. Për këtë arsye, Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP), që nga themelimi i saj e deri më sot, ka miratuar dhe publikuar 187 deklaratat dhe 198 rekomandime nga fusha e shëndetit dhe sigurisë në punë.

Gjithsesi që nuk mund të kontestohet se secila punë, në shkallë më të lartë ose më të ulët, bart rreziqe mbi shëndetin dhe jetën e punëtorit. Në sistemet bashkëkohor, funksional dhe të harmonizuara të shëndetit dhe sigurisë në punë ashtu siç janë inkorporuar në shumë vende të zhvilluara dhe në të gjitha vendet-anëtare të BE-së, kryesisht janë orientuar kah nevoja e ruajtjes dhe rritjes së interesave ekonomike të punëdhënësve, dhe për këtë shkak si domosdoshmëri imponohet implementimi sa më i shpejtë i legjislacionit evropian, normave dhe standardeve të Bashkimit Evropian (BE-së), Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP) dhe

Organizatës Shëndetësore Botërore (OSHB) në fushën e sigurisë së punës dhe shëndetit të punëtorëve.

Falë vlerësimit të Organizatës Ndërkombëtare të Punës dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim, për nevojën e përmirësimit të gjendjeve në aspektin e sigurisë dhe shëndetit në punë, është hartuar Manuali për Ligjin për siguri dhe shëndet gjatë punës, si mjet themelor për qasje në rregullat dhe normat e sigurimit të drejtë të vendit të sigurt të punës.

2. Objektivi kryesor i Manualit për Ligjin për siguri dhe shëndet gjatë punës

- T'u ndihmohet ndërmarrjeve, veçanërisht ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM), interpretimi dhe sqarimi i Ligjit dhe rëndësia e tij, si dhe qasja dhe aplikimi i tij serioz.
- Të sigurohet këshillë dhe ndihmë me të cilat do të mund të zbatoheshin masat për inkorporimin dhe pëmbushjen e detyrimeve mbi bazë të Ligjit.
- Të sigurohet qasje e lehtë deri te informatat e rëndësishme për zbatim profesional të dispozitave të Ligjit.

3. Baza ligjore

Me këtë Ligj përcaktohen masat e sigurisë dhe shëndetit gjatë punës, detyrimet e punëdhënësit dhe të drejtat e detyrimet e të punësuarve nga fusha e sigurisë dhe shëndetit gjatë punës, si dhe masat parandaluese kundër rreziqeve profesionale, shmangiet e faktorëve të rrezikut për fatkeqësi, informimi, konsultimi, trajnimi i punëtorëve dhe përfaqësuesve të tyre si dhe pjesëmarrja në planifikimin dhe marrjen e masave të sigurisë dhe shëndetit gjatë punës.

Dispozitat e këtij Ligji aplikohen në të gjitha veprimtaritë e sektorit publik dhe privat, për të gjithë personat e siguruar nga lëndimet në vendin e punës ose sëmundjet profesionale sipas rregullave për sigurim pensional, invalidor dhe shëndetësor dhe për të gjithë personat e tjerë të cilët janë të përfshirë në proceset e punës.

Dispozitat e këtij Ligjit nuk zbatohen në veprimtaritë në të cilat kjo materie është rregulluar me rregulla të veçanta (forcat e armatosura, policia, në disa aktivitete të veçanta të forcave për mbrojtje dhe shpëtim), si dhe ndaj ndihmësve shtëpiak.

- Detyrim i përgjithshëm i punëdhënësve është të sigurojnë siguri dhe shëndet të punëtorëve në të gjitha aspektet në lidhje me punën e tyre.
- Vlerësimi i rrezikut mundëson që punëdhënësit t'i zbatojnë masat specifike të cilat janë të domosdoshme për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve.
- Në kuadër të Ligjit për siguri dhe shëndet gjatë punës, të gjithë punëdhënësit medoemos duhet rregullisht ta aplikojnë vlerësimin e rrezikut. (Direktiva Kornizë 89/391, e përfshirë në legjisllacionin nacional).

4. Detyrimet e punëdhënësit

Punëdhënësi e ka për detyrë që për të punësuarit e tij të sigurojë siguri dhe shëndet gjatë punës edhe atë nga çdo aspekt që ka të bëjë me punën. Në kuadër të detyrimeve të tij, punëdhënësi medoemos duhet t'i ndërmerr masat e nevojshme për sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve gjatë punës, përfshirë këtu edhe mbrojtjen nga rreziqet profesionale, sigurimin e informatave dhe trajnimeve dhe sigurimin e organizimit përkatës dhe mjeteve të nevojshme, përkatësisht të inkorporojë masa mbrojtëse dhe të zgjedh metoda të atilla të punës dhe prodhimit, me të cilat do të përmirësohet niveli i sigurisë dhe shëndetit gjatë punës, ndërkaq do të përfshihen në të gjitha veprimtaritë e punëdhënësit, si dhe në të gjitha nivelet e organizimit.

Detyrimet dhe punët e sigurisë dhe shëndetit gjatë punës, punëdhënësi mund tua besojë personave të autorizuar juridikë ose fizikë, nëse ai nuk ka mundësi ose nuk ka të punësuar adekuat profesionist dhe pajisje teknike që punët dhe detyrimet e këtilla t'i kryej në mënyrë të pavarur.

Angazhimi i personave juridikë ose fizikë kompetent dhe të autorizuar për kryerjen e detyrave profesionale në lidhje me sigurinë dhe shëndetin gjatë punës, nuk e liron punëdhënësin nga përgjegjësitë e tij në këtë fushë. Detyrimet e të punësuarve në fushën e sigurisë dhe shëndetit gjatë punës nuk ndikojnë mbi parimin e përgjegjësisë së punëdhënësit.

Punëdhënësi i zbaton masat e sigurisë dhe shëndetit gjatë punës mbi bazë të parimeve themelore si vijon:

- shmangien e rreziqeve;
- vlerësimin e rreziqeve të cilët nuk mund të shmangen;
- ballafaqimin me rreziqet që nga fillimi;

- përshtatjen e punës ndaj individit veçanërisht sa u përket karakteristikave të vendit të punës dhe mjedisit të punës;
 - zgjedhjen e pajisjes për mbrojtje personale;
 - zgjedhjen e substancave kimike ose preparateve;
 - zgjedhjen e metodave të punës dhe atyre prodhuese;
 - zbatimin e masave të cilat janë të nevojshme për mirëmbajtjen dhe mirëqenien e shëndetit;
 - përshtatjen drejt përparimit teknologjik;
 - zëvendësimin e të rrezikshmes me të parrezikshmen ose më pak të rrezikshmen;
 - zhvillimin e strategjisë të sigurisë së plotë, e cila përfshinë teknologjinë, organizimin e punës, kushtet e punës, marrëdhëniet ndërnjerëzore dhe faktorët të cilët ndikojnë mbi mjedisin e punës;
 - dhënien prioritet masave të sigurisë kolektive kundrejt masave individuale;
 - sigurimin e udhëzimeve dhe instruksioneve dhe njoftimeve përkatëse për të punësuarit;
 - Si institucion i ri dhe shumë i rëndësishëm për sigurinë dhe shëndetin gjatë punës së punëtorëve është edhe detyrimi i punëdhënësit i cili duhet ta hartojë dhe zbatojë deklaratën për siguri për çdo vend të punës për vlerësimin e rrezikut, duke e saktësuar mënyrën dhe masat të cilat duhet të ndërmerren.
- Nëse ndryshohen kushtet ose nëse shfaqet ndonjë rrezik i ri në vendin e punës dhe në mjedisin e punës, për të cilin paraprakisht është hartuar deklarata, punëdhënësi medoemos duhet të përgatisë deklaratë të re për siguri. Deklarata për siguri bazohet mbi identifikimin e rrezikut dhe vlerësimin e rreziqeve për sigurinë e shëndetin në vendin e punës dhe në mjedisin e punës, me të cilin ka të bëjë deklarata për mbrojtje.

Mënyra e hartimit të deklaratës për siguri, përmbajtja e saj, si dhe të dhënat mbi bazë të të cilave duhet të bazohet vlerësimi i rrezikut janë parashikuar me Rregulloren për mënyrën e hartimit të deklaratës për siguri, përmbajtjen e saj si dhe të dhënat mbi të cilat duhet të bazohet vlerësimi i rrezikut, “Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 5/09.

Punëdhënësi e organizon sigurinë dhe shëndetin gjatë punës, varësisht nga procesi teknologjik, me aplikimin e metodave shkencore-profesionale dhe në përputhje me arritjet bashkëkohore, me ç’rast punët profesionale të sigurisë do t’i kryejë punëtori me përgatitje profesionale për siguri gjatë punës ose me përgatitje tjetër profesionale që është adekuate me procesin teknologjik të punëdhënësit, ose do të shfrytëzojë shërbime nga jashtë nga persona të autorizuar juridikë ose fizikë.

Punëdhënësi medoemos duhet të sigurojë masa të sigurisë dhe shëndetit gjatë punës, veçanërisht përmes:

- caktimit të një ose më shumë personave profesionistë për siguri;
- angazhimit të institucionit të autorizuar shëndetësor për kryerjen e detyrave profesionale për shëndet gjatë punës;
- miratimit të masave të sigurisë kundër zjarrit konform rregullave të veçanta;
- miratimit të masave për ndihmë të parë dhe evakuim në rast të rrezikut;
- trajnimit të të punësuarve për kryerje të sigurt të punëve në bazë të programit vetjak;
- sigurimit të pajisjes për mbrojtje personale për të punësuarit dhe përdorimi i saj, nëse nuk mjaftojnë masat e ndërmarra të sigurisë në mjedisin e punës;

- kontrolleve dhe analizave të kohëpaskohshme të mjedisit të punës dhe pajisjes; dhe
- ndjekjes së gjendjes shëndetësore të të punësuarve.

5. Detyrimet e personit profesionist

- këshillim i punëdhënësit për planifikimin, zgjedhjen, blerjen dhe mirëmbajtjen e mjeteve të punës;
 - këshillim i punëdhënësit për pajisjen e vendit të punës dhe mjedisin e punës;
 - hartimi mbi bazë profesionale të deklaratës së sigurisë;
 - kryerja e kontrolleve dhe analizave të rregullta mbi rreziqet kimike, fizike ose biologjike në mjedisin e punës;
 - kryerja e kontrolleve të rregullta ekzaminuese dhe analiza e pajisjes së punës;
 - kryerja e mbikëqyrjes së brendshme lidhur me zbatimin e masave për kryerjen e sigurt të punës;
 - përgatitja e udhëzimeve për kryerjen e sigurt të punës;
 - ndjekja dhe analiza e lëndimeve që kanë të bëjnë me punën, sëmundjet profesionale, identifikimin e shkaqeve për të njëjtat dhe përgatitja e raporteve për punëdhënësin, së bashku me të gjitha masat e propozuara të sigurisë; dhe
 - përgatitja e programit dhe zbatimi i trajnimeve të të punësuarve për kryerje të sigurt të punës.
- Personi profesionist mund t'i kryejë detyrat e lartpërmendura, nëse e ka dhënë provimin profesional për siguri gjatë punës.

6. Detyrime të tjera të punëdhënësit

Mbrojtja nga zjarri, evakuimi dhe shpëtimi

Punëdhënësi e ka për detyrë në secilin objekt, duke e marrë parasysh procesin teknologjik, materialet të cilët shfrytëzohen gjatë punës, mënyrën e punës, magazinimin e materialeve, si dhe madhësinë e objektit të ndërmerr masa në drejtim që të mos shpërthejë zjarri, ndërkaq nëse i njëjti shkaktohet të zvogëlohet rreziku në masë sa më të vogël të mundshme mbi sigurinë dhe shëndetin e të punësuarve dhe mbi personat e tjerë të pranishëm.

Varësisht nga natyra e procesit të punës, punëdhënësi e ka për detyrë të organizojë dhe të sigurojë evakuim, shpëtim dhe ndihmë të parë në rast të ndonjë gjendje e cila mund ta rrezikojë sigurinë dhe shëndetin e tyre (fatkeqësi elementare, zjarre, shpërthime, lëshimi i materieve mbi kufirin e lejuar dhe ngjashëm), si dhe t'i aftësojë personat të cilët do ta zbatojnë evakuimin dhe shpëtimin. Personave të cilët janë të caktuar për ta zbatuar evakuimin dhe shpëtimin, shuarjen e zjarrit dhe ndihmën e parë, punëdhënësi medoemos duhet t'ua vë në dispozicion pajisjen e nevojshme.

Punëdhënësi e ka për detyrë të përcaktojë planin për evakuim dhe shpëtim në rast të gjendjes së jashtëzakonshme dhe me të t'i njoftojë të gjithë të punësuarit, ndërsa mbi bazë të atij plani medoemos duhet të zbatohen ushtrime praktike, më së paku një herë në dy vjet.

Gjithashtu, e ka për detyrë të organizojë dhe sigurojë dhënien e ndihmës së parë të punësuarve, në rast të lëndimeve gjatë punës ose sëmundjes së papritur deri në dërgimin e tyre për mjekim në institucion shëndetësor. Për çdo vend të punës dhe në çdo ambient pune në të cilët njëkohësisht punojnë deri 20 të punësuar, më së paku një prej tyre duhet të jetë i aftësuar dhe i caktuar për dhënien e ndihmës së parë, për shuarjen e

zjarrit, evakuim dhe shpëtim, ndërkaq mbi këtë shifër në çdo njëzet të punësuar më së paku edhe nga një.

Punëdhënësi duhet të lidhë kontrata me subjekte të tjerë juridikë, të specializuar për dhënien e shërbimeve, veçanërisht për sa i përket dhënies së ndihmës së parë, ndihmës emergjente mjekësore, aktiviteteve për evakuim dhe shpëtim dhe mbrojtje nga zjarri.

Informimi i punëtorëve

Informimi i të punësuarve lidhur me sigurinë gjatë kryerjes së punëve bëhet përmes njoftimeve dhe udhëzimeve me shkrim. Në raste të jashtëzakonshme kur të punësuarit u ekspozohen rrezikut të drejtpërdrejt mbi shëndetin ose jetën e tyre, njoftimet dhe udhëzimet e këtilla mund t'u barten edhe në mënyrë verbale dhe në të njëjtat do të përfshihen të gjitha masat e ndërmarra në lidhje me sigurinë në punë në rast të rrezikut të drejtpërdrejt, serioz dhe të pashmangshëm, punëdhënësi medoemos duhet që të punësuarve tu jap udhëzime përkatëse për ndërprerjen e punës, largimin e shpejtë nga vendi i punës dhe evakuim në ambiente të sigurta. Derisa zgjatë rreziku punëdhënësi nuk guxon t'i angazhojë të punësuarit të kryejnë detyra pune.

Kur një ose më shumë të punësuar janë larguar nga vendi i punës ose nga zona e rrezikshme, për shkak të rreziqeve të drejtpërdrejta ose të pashmangshme mbi sigurinë e tyre në punë, ata nuk mund të merren në përgjegjësi për shkak të reagimit të tyre në situata të këtilla. Punëdhënësi duhet të sigurojë që të gjithë punëtorët gjatë rrezikut serioz ose të drejtpërdrejt mbi sigurinë e tyre ose mbi sigurinë e personave të tjerë edhe në rastet kur nuk mund të kontaktohet me personin profesionist, të ndërmarrin masa përkatëse në kuadër të njohurive të tyre dhe mjeteve teknike të cilat i kanë në dispozicion për t'iu shmangur pasojave nga rreziqet e këtilla. Veprimi i këtillë nuk guxon t'i shpie në një situatë që të

merren në përgjegjësi, përveç nëse kanë vepruar në mënyrë të pakujdesshme dhe të pandërgjegjshme.

Punëdhënësi medoemos duhet t'i informojë të punësuarit dhe përfaqësuesit e tyre për çdo lloj rreziku në vendin e punës, si dhe për masat e sigurisë të nevojshme për kontrollin mbi rreziqet dhe eliminimin e pasojave të dëmshme. Punëdhënësi medoemos duhet t'i informojë edhe të punësuarit me kontratë për punë me kohë të caktuar, të punësuarit e rinj, të punësuarit më të moshuar në përputhje me Ligjin për marrëdhënie pune, si dhe ata me aftësi të kufizuar pune në lidhje me rezultatet e vlerësimit të rrezikut dhe për masat e ndërmarra nga ana e punëdhënësit, me qëllim të sigurimit të sigurisë dhe shëndetit të tyre në punë.

Trajnimi i të punësuarve

Punëdhënësi medoemos duhet që secilit të punësuar t'i sigurojë trajnime përkatëse lidhur me sigurinë dhe shëndetin në punë:

- gjatë punësimit;
- në rast të risistemimit në vend të ri të punës;
- në rast të instalimit të teknologjisë së re ose mjeteve të reja për punë; dhe
- në rast të çdo ndryshimi të procesit të punës, i cili mund ta ndryshojë nivelin e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Trajnimi lidhur me sigurinë dhe shëndetin në punë medoemos duhet të përshtatet me specifikat e vendit të punës dhe i njëjti duhet të realizohet në përputhje me programin i cili duhet të azhurnohet dhe ndryshohet për sa u përket llojeve dhe formave të reja të rrezikut. Trajnimet teorike dhe praktike lidhur me sigurinë gjatë kryerjes së punës realizohen brenda orarit të punës, pranë punëdhënësit ose në ndonjë vend tjetër. Punëdhënësi i përcakton provimet e detyrueshme të

rregullta teorike dhe praktike lidhur me sigurinë gjatë kryerjes së punës për të gjithë të punësuarit në vendet e punës në të cilat është konstatuar rrezik më i madh për lëndime dhe çrregullime të shëndetit gjatë vlerësimit të rrezikut, si dhe për të gjithë të punësuarit në vendet e punës në të cilat është rritur numri i rasteve të lëndimeve në punë dhe rrezikut mbi shëndetin. Për të punësuarit e cekur, punëdhënësi e ka për detyrë që në çdo tre vjet t'u sigurojë kontroll lidhur me aftësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Organizimi dhe realizimi i trajnimeve të punëtorëve dhe përfaqësuesve të tyre do të bëhet në llogari të punëdhënësit.

Inspektori i punës pas mbikëqyrjes së kryer të inspektimit mund të urdhërojë që programi aktual i trajnimit për siguri dhe shëndet në punë t'i përshtatet specifikave të vendit të punës për sa u përket formave dhe llojeve të rrezikut. Në raste të këtilla inspektori mund të urdhërojë përsëritjen e trajnimit përmes aftësimit teorik dhe praktik të të punësuarve në lidhje me sigurinë në punë.

Përfaqësuesit e të punësuarve

Të punësuarit nga radhët e tyre e zgjedhin përfaqësuesin në mbledhje sindikaliste të sindikatës shumicë ose në mbledhjen e të punësuarve. Përfaqësuesi ka mbrojtje të veçantë nga marrëdhënia e punës, të cilën e posedon edhe përfaqësuesi i sindikatës tek punëdhënësi, konform ligjit dhe marrëveshjes kolektive.

Numri i përfaqësuesve do të varet nga numri i të punësuarve, me ç'rast numri nuk mund të jetë më i vogël se:

- mbi dhjetë të punësuar, zgjidhet një përfaqësues;
- dy përfaqësues prej 101 deri në 500 të punësuar; dhe

- tre përfaqësues tek punëdhënësi i cili ka mbi 501 të punësuar.

Numri i përfaqësuesve, mënyra e trajnimit të tyre si dhe mënyra dhe forma e funksionimit të tyre rregullohet me akt të punëdhënësit konform ligjit dhe marrëveshjes kolektive. Në çdo mjedis pune në të cilin ekziston rrezik mbi sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve, pa dallim të numrit të të punësuarve zgjidhet përfaqësues.

Të drejtat e përfaqësuesit të të punësuarve janë:

- t'i vizitojë vendet e punës me qëllim të identifikimi të gjendjes në lidhje me sigurinë në punë;
 - të bisedojë me punëdhënësin për nevojat dhe problemet lidhur me sigurinë dhe shëndetin në punë;
 - ta njoftojë Inspektoratin e Punës për ndërmjetësimin e tij, të merr pjesë, t'i parashtojë perceptimet e veta dhe të ketë qasje në procesverbalin e hartuar nga ana e inspektorit;
 - të kërkojë informata nga punëdhënësi dhe të ketë qasje mbi deklaratat për vlerësimin e sigurisë dhe mbi raportet që janë detyrim i punëdhënësit dhe mbi dokumente të tjera në lidhje me planifikimin dhe rregullimin e sigurisë dhe shëndetit në punë.
- Punëdhënësi medoemos duhet t'i mundësojë përfaqësuesit kryerje pa pengesë të funksionit të tij, përmes sigurimit të kohës përkatëse dhe mjeteve të nevojshme pa uljen e pagës, me ç'rast nuk guxojnë ta vënë në pozitë të palakmueshme për shkak të aktiviteteve të tij.

7. Detyrimi i punëdhënësit për ta informuar inspektorin e punës

Punëdhënësi e ka për detyrë që menjëherë, dhe më së voni brenda 48 orësh, pas ngjarjes, ta njoftojë me shkrim organin e administratës shtetërore kompetent për çështje të inspektoratit të punës, në lidhje me:

- çdo rast të vdekjes;
- aksident kolektiv dhe lëndime gjatë punës të cilët shkaktojnë paaftësi të përkohshme për punë më shumë se tre ditë pune; dhe
- për çdo dukuri e cila paraqet rrezik të drejtpërdrejt dhe e rrezikon sigurinë në punë të të punësuarve.

8. Analiza e vendit të punës, mjedisit dhe mjeteve të punës

Punëdhënësi e ka për detyrë t'i mirëmbajë mjetet e punës në gjendje të rregullt ta kontrollojë funksionalitetit dhe sigurinë e punës përmes kontroleve dhe analizave të kohëpaskohshme, të cilat i bën në mënyrë dhe afate të përcaktuara me aktin të cilin e miraton ai, përkatësisht me udhëzimin e prodhuesit, rregullat dhe standardet teknike.

Nëse me udhëzimin e prodhuesit nuk janë parashikuar afate të tjera, punëdhënësi e ka për detyrë t'i kontrollojë dhe analizojë mjetet e punës:

- para përdorimit të parë;
- pas rikonstruksionit ose avarisë;
- pas zhvendosjes nga një vend në vend tjetër (vinç dhe ngjashëm).

Punëdhënësi nuk guxon t'i vë në përdorim mjetet e punës, të cilat nuk janë kontrolluar dhe analizuar për sa i përket sigurisë

në punë, përkatësisht nëse nuk janë në gjendje të rregullt për punë të sigurt, e as punëtori nuk guxon t'i vë në përdorim mjetet e këtilla të punës.

Punëdhënësi e ka për detyrë në ambientet e punës dhe ato ndihmëse në të cilat zhvillohen procese teknologjike të bëjë analizë të dëmeve kimike, biologjike dhe fizike, mikroklimës dhe ndriçimit.

Punëdhënësi e ka për detyrë që analizat mikro-klimaterike t'i bëjë në periudhën e verës dhe dimrit gjatë kohës së procesit të punës.

Punëdhënësi e ka për detyrë që analizat t'i bëjë më së voni brenda afatit prej një viti nga dita e fillimit me punë, përkatësisht pas çdo ndryshimi të procesit teknologjik, rikonstruksionit të objektit, rikonstruksionit të sistemit të ventilimit, ngrohjes dhe kondicionimit ose pas ndërrimit të pajisjes teknologjike.

9. Evidenca e punëdhënësit

Punëdhënësi e ka për detyrë të mbajë evidencë për:

- trajnimin dhe aftësimin profesional të të punësuarve për sigurinë në punë;
- kontrollin e bëra mbi mjetet e punës;
- analizat e realizuara mbi dëmet fizike, kimike dhe biologjike dhe mbi mikroklimën në ambientet e punës dhe ato ndihmëse, gjegjësisht të vendeve të punës;
- ekzaminimet mjekësore paraprake dhe periodike të të punësuarve; dhe
- sëmundjet profesionale, sëmundjet që kanë të bëjnë me punën, lëndimet gjatë punës dhe rastet e vdekjes në punë.

Ministri i Punës dhe Politikës Sociale me Rregullore e përcakton mënyrën e mbajtjes së evidencës.

10. Të drejtat dhe detyrimet e të punësuarve

Të drejta dhe detyrime të çdo të punësuarit janë: të kujdeset për sigurinë dhe shëndetin personal dhe për sigurinë dhe shëndetin e personave të tjerë që punojnë me të, në përputhje me trajnimet dhe instruksionet që i ka marrë nga ana e punëdhënësit, të jetë i njoftuar me masat e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe të jetë i trajnuar për zbatimin e të njëjtave, personit profesional dhe institucionit shëndetësor të autorizuar t'u parashtrojë propozime, mendime dhe vërejtje lidhur me sigurinë dhe shëndetin në punë.

I punësuarit ka të drejtë ta refuzojë kryerjen e punës nëse paraprakisht nuk është i njoftuar për të gjitha rreziqet dhe dëmet e mundshme ose nëse punëdhënësi nuk ia siguron kontrollin e parashikuar shëndetësor, të refuzojë kryerjen e punës nëse i ekspozohet rrezikut të drejtpërdrejt mbi shëndetin ose mbi jetën, në rastet kur nuk janë zbatuar masat e sigurisë dhe të kërkojë evitimin e të njëjtave nëse punëdhënësi nuk e ka evituar rrezikun ose nuk vepron në përputhje me mendimin e institucionit të autorizuar shëndetësor, i punësuarit mund të kërkojë ndërhyrje nga inspektorati kompetent i punës dhe ta njoftojë përfaqësuesin.

Punëtori mund të punojë në vendin e punës ose në kushte të ekspozimit ndaj rrezikut më të madh nga lëndimet ose çrregullimet e shëndetit (punë në situatë të presionit atmosferik të rritur ose zvogëluar, temperatura të larta ose të ulëta, rrezatime të dëmshme, vibracione të rritura, zhurmë, punë me të sëmurë me sëmundje infektive dhe me materiale infektive, punë në ujë dhe lagështi, punë e rëndë fizike, punë në terren e ekspozuar në kushte të rënda atmosferike dhe rreziqe të tjera, punë në kushte ndriçimi të pamjaftueshëm ose ndriçimi të tepërt, punë në ambiente të ndotura me materie të

dëmshme kimike, punë nën tokë ose nën ujë, punë në lartësi ose në thellësi, punë e bordit fluturues dhe ngjashëm), vetëm në bazë të vlerësimit të institucionit të autorizuar shëndetësor, me të cilin konfirmohet aftësia e të punësuarit për punën përkatëse.

Të punësuarit medoemos duhet t'i respektojnë masat e përcaktuara për shfrytëzimin e drejtë të mjeteve të punës (makina, aparate, vegla, substanca të rrezikshme, pajisje për transport dhe mjete të tjera për prodhim) dhe nuk guxon t'i shkyç, ndërrojë ose t'i heq pjesët mbrojtëse të pajisjes. Të njëjtët medoemos duhet t'i respektojnë masat e përcaktuara të sigurisë dhe shëndetit në punë dhe ta shfrytëzojnë pajisjen e parashikuar për mbrojtje personale dhe pas përdorimit ta kthejë në vendin adekuat, si dhe të bëjnë ekzaminime mjekësore në përputhje me këtë ligj dhe rregullat e tjera nga kjo fushë.

I punësuarit doemos duhet menjëherë ta njoftojë punëdhënësin e tij përmes përfaqësuesit, në mënyrë verbale ose me shkrim, për çdo mangësi, rrezik mbi sigurinë dhe shëndetin ose për ndonjë incident tjetër, me të cilin mund të rrezikohet siguria dhe shëndeti i tij dhe siguria dhe shëndeti i të punësuarve të tjerë. Nëse punëdhënësi nuk ndërmerr masa për evitimin e dukurive ose nëse i punësuar konsideron se nuk janë zbatuar masat përkatëse të sigurisë dhe shëndetit, i punësuarit mund të kërkojë ndërhyrje nga inspektorati kompetent i punës. I punësuarit doemos duhet në mënyrë permanente të bashkëpunojë me punëdhënësin dhe me personin profesionist përderisa të sigurohet mjedis i sigurt për punë dhe kushte pune dhe zbatimi i masave të rekomanduara nga inspektorati kompetent i punës.

11. Autorizimet e Inspektoratit të Punës

Nëse inspektori i punës konstaton shkelje të ligjit ose të ndonjë rregulle tjetër lidhur me sigurinë dhe shëndetin në punë, marrëveshjen kolektive dhe marrëveshjen për punësim me të cilat rregullohen të drejtat dhe detyrimet nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë, mbi zbatimin e të cilave bën mbikëqyrje inspektimi, me aktvendim do të urdhërojë që brenda një afati të caktuar kohor të evitohen parregullsitë dhe mangësitë e konstatuara.

Nëse inspektori i punës në bazë të inspektimit konstaton se te punëdhënësi ekziston rrezik i drejtpërdrejt mbi sigurinë dhe shëndetin në punë të të punësuarve, me aktvendim do ta ndalojë punën në tërësi ose vetëm të një pjese të pajisjes për punë, të një pjese të repartit ose të tërë procesit teknologjik. Po ashtu do ta ndalojë punën e punëdhënësit nëse ai nuk vepron sipas aktvendimit të inspektorit të punës dhe nëse brenda afatit të caktuar nuk i eviton parregullsitë dhe mangësitë e konstatuara.

Nëse shkelja e konstatuar e rregullave të sigurisë dhe shëndetit në punë paraqet mangësi për evitimin e së cilës nevojiten investime të veçanta, ndërkaq jeta dhe shëndeti i të punësuarve në mënyrë të drejtpërdrejt nuk rrezikohen, inspektori i punës me aktvendim mund t'i urdhërojë punëdhënësit që të miratojë program të veçantë për harmonizimin gradual të gjendjes ekzistuese konform rregullave.

Inspektori i punës e ka për detyrë që pas pranimit të njoftimit për ndërmjetësim menjëherë të bëjë inspektim dhe me aktvendim të urdhërojë ndërmarrjen e masave përkatëse për siguri dhe shëndet në punë, përkatësisht nëse sipas të dhënave nga inspektimi konstaton se ekziston rrezik i drejtpërdrejt mbi jetën dhe shëndetin e të punësuarve,

menjëherë me aktvendim do ta ndalojë punën e vendit të punës, pajisjen për punë, përkatësisht një pjesë të procesit tekniko-teknologjik ose tërë procesin. Ndalimet do të jenë në fuqi përderisa nuk zbatohen masat e nevojshme në lidhje me sigurinë dhe shëndetin në punë, përkatësisht derisa nuk evitohet rreziku i drejtpërdrejt mbi jetën dhe shëndetin e të punësuarve gjatë punës.

12. Gjoha

Gjobë në lartësi prej 1000,00 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik nëse:

- nuk u mundëson të punësuarve në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes përfaqësuesit të tyre të marrin pjesë në përcaktimin e mangësive dhe në përmirësimin e kushteve të punës si dhe nëse nuk konsultohet dhe nuk bashkëpunon me të punësuarit dhe përfaqësuesit e tyre për rreziqet dhe pasojat të cilat rezultojnë nga përzgjedhja e pajisjes së punës;
- për shkak të sigurimit të masave të sigurisë dhe shëndetit në punë si dhe çrregullimit të shëndetit të të punësuarve të njëjtat i konsideron si detyrim financiar të të punësuarve;
- nuk i lidh marrëveshjet e nevojshme me shërbimet e jashtme për shërbime të caktuara që kanë të bëjnë me sigurinë dhe shëndetin në punë;
- përmes njoftimeve dhe udhëzimeve me shkrim nuk i informon të punësuarit për siguri gjatë kryerjes së punës;
- i merr në përgjegjës të punësuarit të cilët janë larguar nga vendi i punës për shkak të rrezikut të krijuar serioz dhe të pashmangshëm;
- nuk i informon të punësuarit dhe përfaqësuesit e tyre, të punësuarit e përkohshëm, si dhe të punësuarit e punëdhënësit tjetër, në bazë të marrëveshjes për punë, për çdo rrezik në

vendin e punës si dhe për masat e sigurisë për eliminimin e pasojave të dëmshme;

- të punësuarve dhe përfaqësuesve të tyre nuk u lejon të marrin pjesë në debatet për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me shëndetin dhe sigurinë në punë

- të punësuarve dhe përfaqësuesve të tyre nuk ua prezanton deklaratën e sigurisë;
- përfaqësuesit nuk ia mundëson kryerjen pa pengesë të funksionit të tij;
- nuk mban evidencë për çështjet e përcaktuara në nenin 37 të këtij ligji.

(2) Për shkeljet e lartpërmendura gjobë në lartësi prej 300,00 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës në personin juridik.

(1) Gjobë në lartësi prej 2000,00 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik nëse:

- nuk cakton një ose më shumë persona përgjegjës për siguri në punë në mjedisin e vet të punës;
- nuk angazhon institucion të autorizuar shëndetësor për kryerjen e detyrave profesionale për shëndet gjatë punës;
- nuk miraton masa sigurie kundër zjarrit sipas rregullave të veçanta;
- nuk miraton masa për ndihmë të parë dhe evakuim në rast të rrezikut;
- nuk e njofton organin e administratës shtetërore kompetent për punët e inspektoratit të punës për fillimin e kryerjes së veprimtarisë, tetë ditë para fillimit të të njëjtës;
- para fillimit të punëve ndërtimore me shkrim nuk e njofton organin e administratës shtetërore kompetent për inspektoratin e punës për vendin se ku do të realizohen punimet;

- nuk përcakton plan për evakuim dhe shpëtim në situata të jashtëzakonshme;
 - analizat nga neni 34 të ligjit nuk realizohen në afat prej një viti nga dita e fillimit me punë të objektit, përkatësisht pas çdo ndryshimi të procesit teknologjik, rikonstruksionit të objektit, rikonstruksionit të instalimeve teknike apo gjatë ndërrimit të pajisjes teknologjike;
- (2) Për shkeljet e lartpërmendura gjobë në lartësi prej 500,00 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik.
- (1) Gjobë në lartësi prej 5000,00 deri në 8000,00 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik nëse:
- nuk harton dhe nuk e zbaton deklaratën e sigurisë në formë të shkruar, apo nëse e njëjta nuk është hartuar sipas dispozitës së nenit 11 të këtij ligji;
 - lejon qasje të të punësuarve në vende pune që u ekspozohen rreziqeve serioze dhe specifike kurse të njëjtit nuk kanë marrë udhëzime të veçanta për punë;
 - nuk siguron trajnim të të punësuarve për kryerjen e sigurt të punëve;
 - nuk siguron pajisje mbrojtëse personale për të punësuarit si dhe përdorimin e saj;
 - nuk bën kontrole dhe analiza periodike të mjedisit të punës dhe pajisjes;
 - nuk bën ekzaminime shëndetësore të të punësuarve;
 - nuk organizon dhe siguron dhënien e ndihmës së parë të të punësuarve në rast të lëndimit në punë;
 - çdo të punësuar nuk i siguron trajnim përkatës lidhur me sigurinë dhe shëndetin në punë përmes trajnimit teorik dhe praktik, në rast të punësimit, risistemimit në vend të ri të punës, instalimit të teknologjisë së re ose mjeteve të punës, si dhe në rast të ndryshimit të procesit të punës;

- mjetet e punës nuk i mirëmban në gjendje të rregullt përmes kontrolleve dhe analizave të kohëpaskohshme brenda afateve të përcaktuara me aktin të cilin ai e ka miratuar, përkatësisht sipas udhëzimeve të prodhuesit, rregullave dhe standardeve teknike;
- e vë në përdorim pajisjen e punës të cilës nuk i është bërë kontrolli i sigurisë për punë;
- në ambientet e punës dhe ato ndihmëse nuk e bën kontrollin e dëmeve kimike, biologjike dhe fizike, mikroklimës dhe ndriçimit;
- brenda afatit prej 48 orësh nuk e njofton organin kompetent shtetëror për çështjet e inspektoratit të punës për çdo rast vdekjeje, aksidenti kolektiv, paafësisë stë përkohshme për punë më shumë se 3 ditë si dhe për çdo dukuri e cila paraqet rrezik të drejtpërdrejt dhe rrezikon sigurinë e të punësuarve në punë.
- (2) Për shkeljet e lartpërmendura gjobë në lartësi prej 500,00 deri në 1000,00 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet kundërvajtje personit përgjegjës në personin juridik.
Me gjobë (dënim mandator aty për aty) në lartësi prej 50,00 euro në kundërvlerë me denarë do të dënohet i punësuari, nëse nuk i respekton masat e përcaktuara për siguri dhe shëndet në punë dhe nëse nuk e shfrytëzon pajisjen e caktuar për mbrojtje personale.

13. Aktet nënligjore të Ligjit për siguri dhe shëndet gjatë punës

- Rregullore për pajisjen mbrojtëse personale të cilën të punësuarit e përdorin gjatë punës
- Rregullore për siguri dhe shëndet gjatë punës përmes përdorimit të pajisjes për punë
- Rregullore për shenjat e sigurisë dhe shëndetit gjatë punës
- Rregullore për mënyrën e mbajtjes së evidencës në fushën e sigurisë dhe shëndetit gjatë punës
- Rregullore për siguri dhe shëndet gjatë punës për të punësuarit e ekspozuar në rrezik nga zhurma
- Rregullore për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit gjatë punës për kantier të përkohshëm mobil
- Rregullore për kushtet e të punësuarve, organizimin, kushtet teknike dhe kushtet e tjera të cilat duhet t'i përmbush personi juridik ose fizik për kryerjen e punëve profesionale
- Rregullore për kushtet, mënyrën dhe programin e dhënies së provimit profesional për siguri gjatë punës
- Rregullore për mënyrën e hartimi të deklaratës së sigurisë, përmbajtja e saj, si dhe të dhënat mbi të cilat duhet të bazohet vlerësimi i rrezikut
- Rregullore për kërkesat minimale lidhur me sigurinë dhe shëndetin e të punësuarve në mjedisin e punës
- Rregullore për siguri dhe shëndet gjatë punës gjatë bartjes me dorë të ngarkesës
- Rregullore për masat mbrojtëse gjatë punës me ekrane
- Rregullore për siguri dhe shëndet gjatë punës të të punësuarve të ekspozuar në rrezik nga vibracionet mekanike
- Rregullore për formën dhe përmbajtjen e formularit për njoftimin e fillimit të kryerjes së veprimtarisë
- Rregullore për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit të të punësuarve të cilët në mënyrë potenciale i janë ekspozuar rrezikut nga atmosferat shpërthyesë (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 74/2009)
- Rregullore për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit të të punësuarve nga rreziqet në lidhje me ekspozimin në azbest gjatë punës (Gazeta zyrtare e RM-së 50/2009)

14. Informata

Kontakte:

Organizata Ndërkombëtare e Punës – Shkup, Maqedoni
„Dame Gruev“ nr.14 1000,Shkup
Tel.02-5512694
www.ilo.org

Organizata e Punëdhënësve të Maqedonisë

„Dimitrija Çupovski“ nr.13 1000,Shkup
Tel. 02-3215085
www.orm.org.mk

Konfederata e Punëdhënësve të Republikës së Maqedonisë

„Vasil Gjorgov“ nr. 11 1000, Shkup
Tel. 02- 5511 868
„Stefan Dineski“ nr. 5 7500, Prilep
Tel. 048- 616 159
„Goce Dellçev“ nr. 5 1430, Kavadar
Tel. 043- 412 994
www.cerm.com.mk

Shoqata Maqedonase për Mbrojtje gjatë Punës

„29 Nëntori“ 50 1000, Shkup
Tel. 02-2774 868
www.mzzpr.org.mk

Inspektorati Shtetëror i Punës **Kontakt informativ të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe** **njësive rajonale**

1. Shkup – ISHP (Centrali) 02 3116 – 110 , 02 3224 – 504 , 02 3296 – 310
2. Shkup - Qendër (OP) 02 3 220– 536 , 02 3213 – 184
3. Shkup – Gazi Babë(MSP)02 3115 – 104 , 02 3296 – 315 , 02 3296 – 316
4. Kumanovë 031 423 – 231 , 031 424 – 725
5. Kriva Pallankë 031 375 – 020 , 031 374 – 255
6. Kratovë 031 481 – 099
7. Probishtip 032 484 – 790
8. Sveti Nikolë 032 443 – 126
9. Shtip 032 383 – 503 , 032 383 – 563
10. Vinicë 033 361 – 644
11. Koçan 033 270 – 537
12. Dellçevë 033 411 – 737
13. Strumicë 034 349 – 280
14. Radovish 032 635 – 412
15. Vallandovë 034 382 – 856
16. Gjevgjeli 034 212 – 069
17. Berovë 033 471 – 212 , 033 470 – 072
18. Veles 043 239 – 174
19. Kavadar 043 412 – 480

Doracak për Ligjin për shëndetin dhe sigurinë në punë

| | |
|---------------------|-------------------------------|
| 20. Negotinë | 043 361 – 461 |
| 21. Tetovë | 044 352 – 760 , 044 352 – 761 |
| 22. Gostivar | 042 216 – 500 |
| 23. Dibër | 046 831 – 119 |
| 24. Kërçovë | 045 225 – 170 |
| 25. Manastir | 047 242 – 725 |
| 26. Demir Hisar | 047 276 – 321 |
| 27. Ohër | 046 257 – 670 |
| 28. Prilep | 048 427 – 448 |
| 29. Resnjë | 047 452 – 332 |
| 30. Strugë | 046 783 – 139 |
| 31. Makedonski Brod | 045 275 – 232 |

Informata për tekstin

Materiale të shfrytëzuara nga dokumentacioni për siguri dhe shëndet në punë, analiza profesionale, punime shkencore, strategji, direktiva, enciklopedi nga:

- **ONP/ILO**
- **Ligji për siguri dhe shëndet gjatë punës**
- **Enti Republikan për Mbrojtje Shëndetësore**
- **Legjislacioni i punës**
- **SHMMGjP**
- **KPRM**
- **OPM**
- **Instituti i Mjekësisë së Punës**
- **Konventa të ratifikuara**
- **Strategjia e Bashkimit Evropiane**